



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1108/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Naim Makolli kandidat për asamble të kuvendit komunal nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Prishtinë, paraqitur kundër komisionerëve të qendrave të vendotimeve, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor dhe manipulimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Naim Makolli kandidat për kuvendin komunal në Prishtinë nga radhët e subjekti politik AKR.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Naim Makolli anëtarë nga subjekti politik AAK dega në Prishtinë, i cili thekson se në shkollën fillore “Gjergj Fishta”, në shkollën “Gjin Gazuli” si dhe në shkollën fillore në Hajvali “Shkëndija” dyshon se mbi 50% të votave të tij i janë shënuar kandidatë tjerë, andaj kërkoj që të bëhet rinumrimin i votave në shkollat e lartëcekura me lartë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit Naim Makolli nga komuna e Prishtina. PZAP-i, i vlerëson si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuese andaj ankesa e tillë është e pa bazuar dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartëpërmendura vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1108/2013 më datën 06.12.2013



**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.